

**KQZ-ja publikon shpenzimet
tremujore të subjekteve
politike, LV-ja harxhoi
1 milion e 263 mijë euro**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SBASHK-u NË PËRKRAHJE TË ISH-KRERËVE TË UÇK-së: DALJA NË MARSH ËSHTË AKT MORAL DHE QYTETAR



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka dalë në mbështetje të marshit qytetar "Drejtësi, jo politikë!", i cili do të mbahet më 17 shkurt, në Ditën e Pavarësisë, në Prishtinë. Pas konsultimeve me

strukturat sindikale, kryesia e SBASHK-ut ka bërë thirrje për mobilizim qytetar dhe sindikal në përkrahje të marshit qytetar "Drejtësi, jo politikë!". Në njoftimin e saj, SBASHK-u thekson se kjo çështje ka peshë

të veçantë sindikale dhe historike, pasi shumë nga çlirimtarët e UÇK-së ishin njëkohësisht arsimtarë dhe punëtorë të arsimit. Përkrahje marshit i kanë dhënë edhe komunat dhe organizatat studentore

**"NJË POPULL NUK
I NËNSHTROHET
KEDS-it",
QYTETARËT
KUNDËRSHTOJNË
RRITJEN E ÇMIMIT
TË RRYMËS**



**KUVENDI I
PRISHTINËS
MIRATON
BUXHETIN
PËR VITIN
2026**



AKTUALE



**GREQIA DHE TURQIA, TENSIONE TË
REJA NË EGJE**

**27 VJET NGA KONFERENCA E
RAMBUJESË: KOSOVA FOLI DHE
VENDOSI PËR VETVETEN**

**SERBIA ARRESTON NJË VETERAN
TË UÇK-së**

EKONOMI



**GUVERNATORI I BQK-SË: SEKTORI
BANKAR I KOSOVËS MBETET
NDËR MË TË QËNDRUESHMIT
NË RAJON**

**INSPEKTORATI I TREGUT MBYLL
26 MOTELE DHE VILLA**

SPORT



**KOSOVA SYNON MEDALJE NË PARIS
GRAND SLAM 2026 TË XHUDOS**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

GREQIA DHE TURQIA: TENSIONE TË REJA NË EGJE

ATHINË, 6 SHKURT - Tensione në prag të takimit të pritur mes presidentit turk Rexhep Taip Erdogan dhe kryeministrit grek Kyriakos Mitsotakis. Me sa duket Greqia dhe Turqia duan të bisedojnë përsëri - në nivelin më të lartë. Duke filluar nga e hëna (09.02.26) në Ankara do të mblidhet “Këshilli Suprem i Bashkëpunimit Greqi-Turqi”. Nëse gjithçka shkon sipas planit, në tryezë do të jenë të pranishëm edhe presidenti turk Rexhep Taip Erdogan dhe kryeministri grek Kyriakos Mitsotakis. Ekziston edhe mundësia e një takimi të posaçëm midis dy udhëheqësve në një ditë tjetër. Pas një periudhe të vështirë dhe plot konflikte në Mesdheun Lindor, në vitin 2010 u krijua Këshilli i Lartë i Bashkëpunimit. Ndonjë sukses të madh ai ende nuk ka arritur, megjithatë Këshilli përpiket të promovojë një agjendë pozitive mes dy partnerëve të NATO-s, veçanërisht në fushat e ekonomisë dhe të turizmit. Por ai është mbledhur vetëm pesë herë deri tani. Takimi i fundit u bë në Athinë në dhjetor 2023. “Turqia bën kërkesa dhe pretendime territoriale të njëanshme, që nuk kanë bazë ligjore dhe nuk mund të jenë temë serioze debati”, shpjegonte në atë kohë



Konstantinos Filis, drejtor i kërkimeve në Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Athinës në intervistë me DW. “Greqia pret që Turqia t’i përmbushë gjithmonë kërkesat e saj dhe të bëjë lëshime”, kundërshtonte Fuat Aksu, shkencëtar politik në Universitetin Teknik Yildiz në Stamboll. Që atëherë nuk ka ndryshuar shumë në Detin Egje. Tensioneve u shtohet një pikë tjetër debati: Të enjten e kaluar Turqia përdori sistemin e navigacionit detar “Navtex” për të paralajmëruar për rreziqet e sigurisë dhe aktivitetet ushtarake greke. Paralajmërimet të ngjashme ka pasur edhe në të kaluarën. Në fund të fundit bëhet fjalë

për autoritet në Egje: Kush ka të drejtë të deklarohet përgjegjës për çështjet e sigurisë? Athina flet për një përpjekje të paligjshme të fqinjët të saj për të zgjeruar ujërat e tij territoriale. Një “provokim të ri turk” e konsideron këtë gazeta e njohur javore greke “To Vima”. Nga këndvështrimi turk kjo është thjesht një çështje rutine, që përputhet me legjislacionin aktual, por mund të jetë më shumë se kaq: sipas gazetës proqeveritare Türkiye: “Navtex ka shkaktuar panik në Greqi dhe ka ndryshuar status quon në Egje”. Për kryeministrin grek Mitsotakis mosmarrëveshja për Navtex do të thotë edhe më shumë presion nga e djathta.

“Turqia po rrëmben gjysmën e Egjeut, por qeveria jonë nuk sheh asnjë arsye për shqetësim”, ankohet Kyriakos Velopoulos, kryetar i partisë së djathtë populiste “Zgjidhja Greke” (EL), e cila, sipas sondazheve, ka arritur vendin e tretë sa i përket mbështetjes së votuesve. Prej dekadash Greqia dhe Turqia grinden për shelfin kontinental para bregdetit turk, shfrytëzimin e lëndëve të para dhe për një zgjerim të mundshëm të ujërave territoriale në Egje. Në kuadër të doktrinës së saj ushtarake aktuale “Atdheu Blu”, Turqia pretendon edhe territore detare prej më shumë se 450 000 kilometra katrorë para bregdetit të saj. Sipas

Konventës së OKB-së mbi të Drejtën e Detit, çdo shtet mund të përcaktojë në parim ujërat territoriale, që shtrihen deri në 12 milje detare. Por ekziston një përjashtim i rëndësishëm: Në rastet e kufijve të paqartë ose mbivendosjeve, palët e përfshira duhet të arrijnë një marrëveshje dypalëshe. Por marrëveshja midis Greqisë dhe Turqisë është ende në pritje.

Anketë: Shqetësimet për gjendjen në Gjermani, në rritje

Berlin, 6 shkurt - Në sondazhin e fundit të ARD-Deutschlandtrend, SPD ka fituar çuditërisht simpati, ndërsa CDU dhe CSU kanë humbur disi mbështetjen e qytetarëve. Humbje të lehta për konservatorët e kancelarit Friedrich Merz, rritje e lehtë simpatie për partinë bashkëqeverisëse, social-demokratët. Këto janë gjetjet kryesore të sondazhit të emisionit ARD-Deutschlandtrend të kryer nga instituti infratest-dimap. Nga tjetër një numër gjithnjë e në rritje njerëzish në Gjermani besojnë se në vend ka padrejtësi kryesisht sepse hendeuku midis të pasurve dhe të varfërve po zgjerohet.

KONSERVATORËT PO HUMBASIN, EDHE AFD-JA, NDËRSA SPD PO FITON TERREN

Edhe këtë herë pyetja e sondazhit të ARD-Deutschlandtrend ishte se për cilën parti do të votonin njerëzit nëse të dielën e ardhshme do të zhvilloheshin zgjedhjet për parlamentin. E ashtuquajtura “pyetje e së dielës” ofron një tregues të mirë se sa simpati gëzojnë partitë aktualisht. Në fillim të shkurtit, dy partitë konservatore, CDU dhe CSU, morën 26 për qind të votave, duke pësuar humbje të lehta krahasuar me fillimin e vitit. Alternativa për Gjermaninë (AfD), e cila konsiderohet pjesërisht ekstremiste e djathtë, humbi pak mbështetje gjithashtu, por mbeti partia e dytë më e fortë me 24 për qind. Socialdemokratët, partneri i vogël i koalicionit në qeverinë federale, fitoi çuditërisht dy për qind. Dy partitë opozitare, të Gjellbrit dhe Partia e Majtë, mbetën në nivelet e tyre të janarit. Vlen të përmendet se

kënaqësia e përgjithshme kundrejt qeverisë është rritur pak, megjithëse në një nivel i ulët. Kurse social-demokratët po përfitojnë, kryesisht sepse kreu i partisë së tyre, Ministri i Financave Lars Klingbeil, ka një rritje të ndjeshme popullariteti në publik. Politikani më i vlerësuar në Gjermani mbetet prej shumë muajsh ministri i Mbrojtjes Boris Pistoriusi SPD-së, që vazhdon të jetë qartësisht në krye. Ai pasohet nga ministri i Jashtëm Johann Wadephul (CDU), pastaj Klingbeil, i cili ka fituar pesë për qind. Friedrich Merz është në 25 për qind. Klingbeil kohët e fundit përdori një ton më të ashpër se Kancelari në lidhje me politikën shpesh të paparashikueshme të presidentit të ShBA-së Donald Trump. Në favor të social-demokratëve shkon edhe shqetësimi në rritje i popullsisë për gjendjen në Gjermani. Në shkurt, 62 për qind e të anketuarve mendonin

se në Gjermani po rritet padrejtësia. Të pyetur për arsyet për këtë, shumica e njerëzve në këtë grup theksuan se hendeuku midis të pasurve dhe të varfërve po zgjerohet. 13 për qind më shumë se në sondazhin e mëparshëm besojnë se barra e taksave dhe e kontributeve nuk shpërndahe në mënyrë të drejtë. Por vetëm 9 për qind, më pak se në sondazhin e mëparshëm, besojnë se të huajve dhe azilkërkuesve u jepet trajtim preferencial krahasuar me gjermanët. Njëzet e katër për qind e të anketuarve u besojnë më shumë social-demokratëve që mund të sigurojnë drejtësi më të madhe sociale. Kjo është shifra më e lartë nga të gjitha partitë. Në fillim të vitit një komision ekspertësh i paraqiti qeverisë gjermane një katalog gjithëpërfshirës propozimesh se si shteti social mund të modernizohet në mënyrë kuptimplote. Këto kërkesa



dominuan titujt kryesorë të gazetave për ditë të tëra. Nevoja për të ristrukturuar sistemin social gëzon mbështetje të gjerë: 71 për qind e të anketuarve thanë se do të ishte e dobishme nëse kërkesa për ndihma dhe përfitime sociale mund të bëhet në mënyrë digjitale. Megjithatë pati kritika të konsiderueshme për deklaratën e Kancelarit Friedrich Merz se shumë njerëz

në Gjermani punojnë me kohë të pjesshme. Kërkesat nga radhët e CDU-së që njerëzit duhet të paguajnë vetë për vizitat e tyre dentare gjithashtu shkaktuan kritika të mëdha. Kjo mund të shpjegojë gjithashtu rënien e përqindjes së simpatie për konservatorët. Për anketën ARD-Deutschland Trend, infratest-Dimap intervistoi afërsisht 1 300 qytetarë në periudhën 2 dhe 4 shkurt.

Serbia arreston një veteran të UÇK-së

PRISHTINË, 6 SHKURT - Një ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shtetas i Kosovës, është arrestuar nga autoritetet në Serbi paraditen e 5 shkurtit, thanë nga Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL UÇK) dhe avokati Arianit Koci. Autoritetet serbe konfirmuan se Mit'hat Lozhani u arrestua nën dyshimet për krime kundër popullatës civile. Nënkryetari i OVL të UÇK-së, Gazmend Sylja, tha për Radion

Evropa e Lirë se Lozhani u arrestua në kufirin mes Serbisë dhe Kroacisë dhe gjatë kontrollit i është gjetur në xhep kartela e anëtarësisë së veteranit të UÇK-së. Sylja shtoi se ai ka marrë pjesë në disa stërvitje në Shqipëri dhe nuk ka informacione të ketë qenë në vijat e frontit në Kosovë. Ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ivica Dačić, tha se i arrestuari është nga Peja dhe ai dyshohet për krime kundër popullatës civile.

Sipas tij, Mit'hat Lozhani është dërguar në ndalim prej 48 orësh dhe më pas do të dërgohet para Zyrës së Prokurorisë për Krime Luftë ku do t'i ngrihet aktakuza. Sipas Serbisë, ai dyshohet se ka kryer trajnime si pjesëtar i UÇK-së i Zonës Operative të Dukagjinit më 1998 dhe 1999 "pas të cilave ka marrë pjesë në sulme terroriste kundër anëtarëve të MPB-së serbe dhe ushtrisë jugosllave". Në njoftim thuhet se "si anëtar i grupit të komanduar nga



Ramush Haradinaj, ai ka marrë pjesë në rrëmbim dhe masakrim të policëve". Ndërkaq avokati Arianit Koci tha se arrestimi ndodhi rreth

orës 11:00 të 5 shkurtit. Sipas tij, ky rast nuk është i izoluar, pasi arrestimet e shtetasve të Kosovës që kalojnë nëpër Serbi po përsëriten.

“NJË POPULL NUK I NËNSHTROHET KEDS-IT”, QYTETARËT KUNDËRSHTOJNË RRYTJEN E ÇMIMIT TË RRYMËS

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 SHKURT - Qytetarët kanë protestuar të premten para objektit të KEDS-it në Prishtinë, duke kundërshtuar njëzëri mundësinë edhe të një tjetër rritje të çmimit të energjisë. Në pankarta shihej mbishkrimi ku i janë përgjigjur ministres në detyrë të Ekonomisë, Artane Rizvanolli, se gjoja po sakrifikojnë për një energji të sigurt në të ardhmen. “Nuk sakrifikojmë na për KEDS”, “Rryma nuk është luks”, “ZRRE, argatë të KEDS-it”, “Rryma rritet, populli djeget”, “Një popull



nuk i nënshtrohet KEDS-it”, ishin disa nga pankartat që qytetarët protestues mbanin në duar. Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist dhe organizata “Përpjekja”,

kërkesën e KESCO-s që të bëhet edhe një rritje e çmimit të energjisë prej 21.3-përqindësh e kanë cilësuar proces të padrejtë dhe të dëmshëm për qytetarët e Kosovës.

Një protestues është arrestuar teksa po protestonte kundër shtrenjtimit të rrymës. Ai u arrestua pasi gjuajti ngjyrë të kuqe, ani pse ai thoshte se nuk e gjuajti atë. Qytetari Sylejman Krasniqi, i cili protestonte, ka bërë me dije se ka parë njerëz të cilët kanë marra para borxh për të blerë një bukë, madje edhe vetë ai thotë se fatura e rrymës i vinte deri në 50 euro e tani po paguan mbi 300 euro. Ndërkaq qytetarja tjetër Sevdije Sadiku ka thënë se si pasojë e çmimit të lartë të rrymës shumë familje nuk do të mund t’ia dalin ta bëjnë pagesën dhe, si pasojë, KEK-u do t’iu këpusë rrymën dhe do

të mbetet në terr, ndërkohë që thekson se vetë pushtetarët po jetojnë një jetë luksi, duke vozitur edhe xhipa të zi. “Populli ka për të mbetur në terr. Një pjesë e madhe kemi mbetur borxh te KEK-u dhe kemi për të mbetur në terr. Ja, kjo është qeveria jonë. Këta vetë i kanë rregulluar punët, sepse vozitën me xhipa të zi. Kanë para, kanë luks dhe hanë ushqime të mira. Ne si do të jetojmë? Çfarë do të hamë e çka do të pimë? Ne veç rrymën duhet ta paguajmë dhe ujin, pra për t’ia plotësuar shtetit pagesat. Çdo ditë njerëzit po ikin për një jetë më të mirë”, ka thënë Sadiku.

KQZ-ja PUBLIKON SHPENZIMET TREMUJORE TË SUBJEKTEVE POLITIKE, LV-ja HARXHOI 1 MILION E 263 MIJË EURO

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 SHKURT - Me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 08/L-122 për Financim të Subjekteve Politike, në uebfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë publikuar raportet e shpenzimeve të tremujorit (tetor - dhjetor 2025) të subjekteve politike të cilat

ishin pjesë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rezultateve të zgjedhjeve të mbajtura më 9 shkurt 2025. Sipas këtij ligji, subjektet politike i dorëzojnë këto raporte në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) dhe të njëjtat publikohen në uebfaqen e KQZ-së dhe të subjekteve



politike. Sipas njoftimit të KQZ-së, Lëvizja Vetëvendosje (LV)

kryeson listën e shpenzimeve me rreth 1 milion e 263 mijë euro të shpenzuara gjatë kësaj periudhe tremujore. Në vend të dytë renditet Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka shpenzuar rreth 280 mijë e 822 euro. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka raportuar shpenzime në vlerë rreth 224 mijë e 859 euro për periudhën tetor - dhjetor 2025.

Nga ana tjetër, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka raportuar shpenzime 70 mijë euro gjatë kësaj periudhe raportuese. KQZ ka bërë me dije se publikimi i këtyre të dhënave bëhet në kuadër të transparencës dhe monitorimit të financimit të subjekteve politike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Osmani: Përgjatë viteve Kosova dhe Emiratet kanë hapur një epokë të re të partneritetit

PRISHTINË, 6 SHKURT - Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se është e nderuar me mikpritjen dhe diskutimet gjithnjë përmbajtjesore me presidentin e Emirateve, Sheikh Mohamed bin Zayed Al Nahyan, të cilin e ka falënderuar për leadershipin e tij vizionar dhe për mbështetjen e vazhdueshme për Kosovën, që nga ditët më të vështira e deri më sot. Ajo ka thënë se përgjatë

viteve kanë hapur një epokë të re të partneritetit ndërmjet dy vendeve, nga liberalizimi i vizave e deri te kontributet e çmuara të Emirateve në fusha konkrete të zhvillimit. “Në veçanti shpreha mirënjohjen e popullit të Kosovës për kontributin e Emirateve në fushën e shëndetësisë si dhe për vijimin e projektit të rëndësishëm të ndërtimit të spitalit të ri të ginekologjisë, i

mbështetur në dakordimin tonë të mëhershëm. Po ashtu, e vlerësoj lart mirëkuptimin e plotë dhe mbështetjen e presidentit për projektet e reja në fushën e shëndetësisë dhe në fusha të tjera zhvillimore që i prezantuam dje. Kosova është e bekuar me mbështetjen e vazhdueshme të presidentit Mohamed bin Zayed dhe të të gjithë popullit të Emirateve”, ka thënë Osmani.





SBASHK-u NË PËRKRAHJE TË ISH-KRERËVE TË UÇK-së: DALJA NË MARSH ËSHTË AKT MORAL DHE QYTETAR

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka dalë në mbështetje të marshit qytetar “Drejtësi, jo politikë!”, i cili do të mbahet më 17 shkurt, në Ditën e Pavarësisë në Prishtinë. Pas konsultimeve me strukturat sindikale, kryesia e SBASHK-ut ka bërë thirrje për mobilizim qytetar dhe sindikal në përkrahje të marshit qytetar “Drejtësi, jo politikë!”. Në njoftimin e saj, SBASHK-u thekson se kjo çështje ka peshë të veçantë sindikale dhe historike, pasi shumë nga çlirimtarët e UÇK-së ishin njëkohësisht arsimtarë dhe punëtorë të arsimit. Përkrahje për këtë marsh kanë shprehur edhe komunat dhe organizatat studentore

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Platforma “Liria ka Emër” shpreh mirënjohjen dhe falënderimin e saj të thellë ndaj Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës të Kosovës (SBASHK) për thirrjen publike dhe mbështetjen e qartë në përkrahje të marshit qytetar “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë.

Qëndrimi i SBASHK-ut përfaqëson një zë të fuqishëm moral, qytetar dhe sindikal në mbrojtje të drejtësisë së paanshme dhe respektimit të sakrificës së çlirimtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët po përballen me një proces të zgjatur dhe të padrejtë në Hagë.

Në mënyrë të veçantë, vlerësojmë theksimin që SBASHK-u i bën rolit historik të mësimdhënësve dhe punëtorëve të arsimit, të cilët, përveçse bartës të dijes dhe dijes kombëtare, ishin edhe pjesë aktive e rezistencës, sakrificës dhe luftës për liri. Ky dimension e bën edhe më

domethënëse mbështetjen sindikale për këtë kauzë qytetare.

Thirrja e SBASHK-ut dëshmon se marshi “Drejtësi, jo politikë” nuk është akt politik, por akt ndërgjegjeje, solidariteti dhe përgjegjësie historike, në përputhje me vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti i Kosovës. Platforma “Liria ka Emër” ka falënderuar kryesinë dhe anëtarësinë e SBASHK-ut për këtë qëndrim dinjitoz dhe do ta vazhdojë bashkëpunimin me të

gjitha organizatat, sindikatat dhe qytetarët, me qëllim të mobilizimit sa më të gjerë për marshin e 17 shkurtit, nën moton “Drejtësi, jo politikë”.

Organizatrat studentore të Kosovës mbështesin marshin “Drejtësi, jo politikë” më 17 shkurt

Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha

dhe Ismail Tasholli, janë takuar me përfaqësuesit e organizatave studentore UDS, SKV, USPE dhe REFORMA, të cilat janë pjesë e Parlamentit Studentor të Universitetit të Prishtinës.

Gjatë takimit organizatat studentore shprehën mbështetjen e tyre të plotë për marshin qytetar “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, duke theksuar se studentët, si historikisht ashtu edhe sot,

kanë qenë dhe mbeten në vijën e parë të thirrjeve për dinjitet, drejtësi dhe liri në Kosovë.

Eliza Hoxha ka theksuar se përfshirja e studentëve në këtë marsh është mesazh i fuqishëm qytetar: “Studentët kanë qenë gjithmonë zëri më i ndershëm dhe më i guximshëm i shoqërisë sonë. Mbështetja e tyre për marshin ‘Drejtësi, jo politikë’ dëshmon se kjo nuk është një kauzë e një grupi, por një thirrje e brezit që kërkon drejtësi dhe respekt për historinë tonë çlirimtare”, ka thënë Hoxha.

Ndërkaq Ismail Tasholli ka theksuar se marshi i 17 shkurtit nuk është kundër askujt, por në mbrojtje të parimeve themelore: “Ky marsh është një thirrje qytetare për respektimin e drejtësisë dhe për mbrojtjen e të vërtetës së luftës çlirimtare të popullit tonë. Pjesëmarrja dhe mbështetja e studentëve i jep kësaj thirrjeje legjitimitet moral dhe shoqëror”, ka thënë Tasholli.

Hoxha dhe Tasholli i falënderuan organizatat studentore për përkrahjen, duke vlerësuar angazhimin e tyre si dëshmi se shoqëria e



27 VJET NGA KONFERENCA E RAMBUJESË: KOSOVA FOLI DHE VENDOSI PËR VETVETEN

PRISHTINË, 6 SHKURT - Më 6 shkurt 1999, për herë të parë në histori, Kosova ishte e pranishme në një konferencë ndërkombëtare të organizuar nga shtetet e Grupit të Kontaktit në Rambuje të Francës. Në këtë konferencë, që u mbajt nën organizimin e bashkësisë ndërkombëtare, morën pjesë përfaqësues të Kosovës dhe të Serbisë. Në krye të delegacionit të Kosovës, që përbënte forcat themelore politike, ishte përfaqësuesi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, anëtarët e tjerë Ibrahim Rugova, Rexhep Qosja dhe Veton Surroi.

Konferenca, që zgjati 17 ditë, nuk solli nënshkrimin e dokumentit të mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës në Kosovë, kurse Grupi i Kontaktit vendosi që negociatat të vazhdojnë më 15 mars në Paris. Rrethi i dytë i negociatave përfundoi me nënshkrimin e dokumentit nga pala shqiptare dhe refuzimin e palës serbe. Një javë më vonë, më 24 mars, filloi bombardimi i caqeve serbe nga NATO-ja.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka kujtuar të premtën 27-vjetorin e fillimit të Konferencës së

Rambujesë, duke e cilësuar atë si një nga momentet më vendimtare në historinë moderne të Kosovës. Në “Facebook”, me këtë rast, Hamza ka theksuar se në Rambuje Kosova për herë të parë foli dhe vendosi për vetveten, duke u rreshtuar qartë në anën e paqes, lirisë dhe vlerave perëndimore, nën udhëheqjen e Hashim Thaçit. “Më 6 shkurt 1999 filloi Konferenca e Rambujesë, një moment vendimtar në historinë tonë. Kosova foli dhe vendosi për vetveten. Nën udhëheqjen e Hashim Thaçit, si kryesues i delegacionit, zgjodhëm paqen, lirinë dhe anën e drejtë të historisë. Nëntë vjet më vonë, shpallëm edhe Pavarësinë e Kosovës”, ka shkruar Kryetari Hamza.

Ai ka shtuar se kjo rrugë drejt lirisë dhe shtetndërtimit nuk do të ishte e mundur pa sakrificën e heronjve dhe mbështetjen e aleatëve ndërkombëtarë. “Sot nderojmë heronjtë tanë dhe falënderojmë të gjithë aleatët, që na mbështetën në çdo hap të lirisë dhe shtetndërtimit”, ka theksuar kreu i PDK-së.

Në fund të reagimit të tij, Hamza ka nënvizuar se perspektiva euroatlantike e



Kosovës lidhet ngushtë edhe me drejtësinë për ish-krerët e luftës që po mbahen në Hagë. “E ardhmja euroatlantike e Kosovës kërkon drejtësi e liri edhe për çlirimtarët tanë në Hagë, të cilët gjithnjë kanë qenë faktorë të stabilitetit dhe ndërtues të vizionit perëndimor të shtetit tonë”, ka

përfunduar Hamza.

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se Rambujeja e lidhi fatin e Kosovës me ShBA-në dhe NATO-n në mënyrë të pakthyeshme. “Ishte hallka e parë ndërkombëtare në themelin e Kosovës së lirë dhe të pavarur, në anën e drejtë të

historisë dhe gjeopolitikës. Me të, 27 vjet më parë, delegacioni i Kosovës i parë nga Hashim Thaçi hapi rrugën për largimin e ushtrisë serbe, vendosjen e trupave të NATO-s, ndërtimin e institucioneve demokratike dhe procesin që çoi drejt statusit të Kosovës”, ka thënë Hoxhaj.

Kosova mund t’i fitojë mbi 800 milionë euro të BE-së, por institucionet ende të paformuara



PRISHTINË, 6 SHKURT - Edhe pse vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë filluar t’i marrin pagesat e para nga Plani i Rritjes, Kosova në krizë institucionale për një vit me radhë s’ka arritur ende ta ratifikojë marrëveshjen e nevojshme për t’i marrë mjetet financiare.

Në zgjedhjet e fundit parlamentare partia e parë mori një rezultat që ia mundëson krijimin e shpejtë të Kuvendit dhe të qeverisë, përpos nëse vetë zgjedh ta bllokojë procesin. Kjo shpejtësi

nevojitet edhe për fondet e BE-së.

Në një përgjigje për “Kallxo.com”, Komisioni Evropian konfirmoi se, edhe pse Kosova është vonuar në ratifikim, ajo ende mbetet e kualifikuar për t’i përfituar fondet. “Kosova mbetet e kualifikuar për të përfituar deri në 882 milionë euro financime në kuadër të Planit të Rritjes, subjekt i hyrjes në fuqi të marrëveshjeve që lidhet me Instrumentin e Reformës dhe Rritjes, si dhe i përmbushjes së të gjitha kushteve të tjera për

pagesë”, tha një zëdhënës i Komisionit për median. “Pa ratifikimin e këtyre marrëveshjeve Kosova nuk mund të paraqesë kërkesë për pagesë në kuadër të Instrumentit të Reformës dhe Rritjes”, thuhet në këtë përgjigje.

Institucionet e reja duhet të formohen para 4 marsit, kur Kosova hyn në procesin e zgjedhjes së presidentit të ri. Pra, qeveria e re do të ketë shumë pak kohë për të manovruar edhe për çështjen e fondeve nga Plani i Rritjes.

Kosovës, e udhëhequr edhe nga të rinjtë, nuk do të heshtë përballë padrejtësive.

Sami Lushtaku i jep mbështetje marshit “Drejtësi, jo politikë” më 17 shkurt

Përfaqësuesit e platformës “Liria ka Emër”, Eliza Hoxha dhe Ismail Tasholli, kanë vizituar të premtën komunën e Skenderajt dhe janë pritur nga kryetari Sami Lushtaku, bashkë me administratën komunale, të cilët kanë shprehur mbështetjen e tyre për marshin qytetar “Drejtësi, jo politikë”, që do të mbahet më 17 shkurt në Prishtinë, në mbrojtje të

drejtësisë së paanshme dhe të vlerave të luftës çlirimtare.

Gjatë këtij takimi Hoxha dhe Tasholli kanë paraqitur aktivitetet dhe qëllimet e platformës “Liria ka Emër”, duke theksuar rëndësinë e mobilizimit qytetar për mbrojtjen e drejtësisë dhe dinjitetit kombëtar, si dhe kanë shprehur mirënjohje për mbështetjen e ofruar nga komuna e Skenderajt. “Ky marsh është një thirrje qytetare për respektimin e drejtësisë së paanshme dhe për ndarjen e saj të qartë nga politika, në mbrojtje të së vërtetës historike dhe të vlerave të luftës sonë çlirimtare”, ka deklaruar Ismail Tasholli. Ndërsa Eliza Hoxha ka theksuar se përkrahja nga

komunat dhe udhëheqësit lokalë po e fuqizon këtë kauzë qytetare. “Mbështetja që po marrim nga kryetarët e komunave është dëshmi se kjo kauzë është mbi politikën ditore dhe përfaqëson një interes të përbashkët qytetar”, u shpreh ajo.

Nga ana e tij, kryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka shprehur mbështetje të plotë për marshin e 17 shkurtit dhe ka bërë thirrje për pjesëmarrje të gjerë qytetare. “Ky marsh për drejtësi dhe për çlirimtarët tanë që po mbahen në Hagë meriton përkrahjen dhe pjesëmarrjen e çdo qytetari të Kosovës”, ka deklaruar Lushtaku.

Platforma “Liria ka Emër” do t’i



vazhdojë takimet dhe aktivitetet në të gjitha komunat e Kosovës, me synim mobilizimin sa më të

gjerë qytetar për marshin e 17 shkurtit në Prishtinë, me moton “Drejtësi, jo politikë”.

“Trafiku Urban” paralajmëron se do ta fillojë grevën më 13 shkurt

PRISHTINË, 6 SHKURT - Punëtorët e ndërmarrjes publike “Trafiku Urban” në Prishtinë kanë paralajmëruar nisjen e një greve që do të fillojë më 13 shkurt. Ky paralajmërim për grevë thonë se vjen pasi nuk morën një përgjigje zyrtare për kërkesat që i kanë bërë edhe në janar. Në njoftimin e dorëzuar te menaxhmenti i ndërmarrjes, punëtorët theksojnë se bazuar

në Kushtetutën dhe Ligjin për Grevën, deri më 6 shkurt nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga organet kompetente lidhur me kërkesat e tyre. Kërkesat përfshijnë përmirësimin e kushteve të punës dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve, me qëllim që të mos cenohen interesat publike dhe siguria e qytetarëve. “Bazuar në nenin 44 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës (Liria e Asociimit), Ligjin nr. 03/L-200 për Grevat, konkretisht nenin 10 paragrafi 1 (njoftimi me shkrim së paku 7 ditë para fillimit të grevës), si dhe nenet përkatëse që rregullojnë organizimin e grevës në shërbimet me interes të përgjithshëm. Ju rikujtojmë se me datë 26.01.2026 është bërë njoftimi paraprak lidhur me kërkesat e parashtruara dhe

paralajmërimin për hyrje në grevë në rast të mosmarrjes së përgjigjes. Duke qenë se deri më datë 06.02.2026 nuk kemi pranuar përgjigje zyrtare nga organet kompetente, ju njoftojmë se punëtorët do të hyjnë në Grevë me datë 13.02.2026. Në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë shërbimet publike me interes të përgjithshëm, garantohet respektimi i



minimumit të procesit të punës, në mënyrë që të mos rrezikohet interesi publik dhe siguria e qytetarëve”, thuhet në njoftimin e tyre.

KUVENDI I PRISHTINËS MIRATON BUXHETIN PËR VITIN 2026

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar të premtën buxhetin për vitin fiskal 2026 me shumicë votash nga anëtarët e tij, buxhet ky që kalon mbi 150 milionë euro. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ky buxhet është ndërtuar sipas prioriteteve dhe vizionit zhvillimor dhe transformues të kryetarit Perparim Rama, me një qasje afatgjatë dhe të orientuar drejt qytetarit, duke krijuar bazën për investime dhe ndërhyrje konkrete në sektorët kryesorë që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe në të ardhmen e Prishtinës. Buxheti i miratuar përfshinë: Investimet kapitale dhe infrastruktura urbane - projekte për rrugë, sheshe, ndriçim publik, hapësira të gjelbra dhe



transport urban, si shtylla kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm të kryeqytetit; Shërbimet publike dhe funksionimin e qytetit - mirëmbajtja, pastërtia,

mobiliteti, siguria dhe funksionaliteti i hapësirave publike; Shëndetësinë dhe arsimin - përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të shërbimit për fëmijët, familjet

dhe profesionistët; Mirëqenien sociale - mbështetje për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë dhe forcim i solidaritetit institucional; Kulturën, rininë dhe sportin -

investime që forcojnë identitetin urban, nxisin kreativitetin dhe krijojnë perspektivë për brezat e rinj; Administratën dhe shërbimet komunale - garantim i stabilitetit institucional dhe ofrim më efikas i shërbimeve për qytetarët. Aprovimi i buxhetit, përveç të tjerash, krijon siguri institucionale dhe i hap rrugë zbatimit të projekteve zhvillimore, duke e bërë këtë dokument të gatshëm për inkorporim në Buxhetin e Republikës i cili pritet të procedohet sapo të formohen institucionet qendrore. Lëvizja Vetëvendosje ka votuar kundër këtij buxheti, duke e cilësuar si problematik në disa aspekte dhe duke kërkuar më shumë transparencë dhe llogaridhënie për përdorimin e mjeteve financiare.

DAKA: PRESIDENTJA OSMANI MË SHKARKOI NË MËNYRË ANTIKUSHTETUESE, QËLLIMI ISHTE SHKATËRRIMI I KQZ-së

PRISHTINË, 6 SHKURT - Ish-kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka treguar synimet që presidentja Vjosa Osmani ka pasur me shkarkimin e saj. Me këtë veprim, ka thënë ajo, e para e shtetit kishte për synim shkatërrimin e institucionit që organizon zgjedhjet në Kosovë. Në një intervistë për “Vox Kosova”, ajo ka deklaruar se këtë e kanë vërtetuar dy palë zgjedhjet e fundit. “Natyrish që tash ndoshta nga kjo perspektivë dhe nga krejt kjo që po ndodh këto ditë me KQZ-në dhe me zgjedhjet, sidomos me këto dy proceset e fundit, vërehet se cila ka qenë intenca e shkarkimit tim. Ajo

ka qenë që KQZ-ja, thjesht ta them, të shkatërrohet”, ka thënë Daka. Ajo është shprehur e bindur se shkarkimi i saj ka qenë antikushtetues. Sipas saj, askush nuk i di pse është shkarkuar. “Në fakt, askush nuk e di për çka jam shkarkuar. Ndoshta vetëm presidentja e di atë dhe ata të cilët i kanë sugjeruar shkarkimin tim. Dhe natyrisht që është cenuar edhe rendi kushtetues sepse KQZ-ja është organ i pavarur kushtetues dhe është prekur pavarësia e atij organi. Sepse një kryetar i KQZ-së mund të shkarkohet ashtu vetëm si e parashihet Kushtetuta dhe jo ashtu si jam shkarkuar unë”, ka deklaruar Daka.



Drejtorja e Arsimit në Mitrovicë dhe OSBE-ja diskutojnë për avancimin e arsimit gjithëpërfshirës

MITROVICË, 6 SHKURT - Drejtori i Arsimit në Mitrovicë, Shefki Begu, priti në një takim zyrtar përfaqësues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), të kryesuar nga Anne-Sophie Vernier, zyrtare e

lartë për komunitete. Gjatë takimit u diskutuan mundësitë e bashkëpunimit ndërinstitucional, me theks të veçantë për mbështetjen e nxënësve nga komunitetet si dhe për forcimin dhe zhvillimin e

qendrave mësimore me bazë në shkollë dhe në komunitet. Takimi u vlerësua si hap i rëndësishëm drejt avancimit të arsimit gjithëpërfshirës, rritjes së barazisë në arsim dhe përmirësimit të qasjes së

nxënësve nga komunitetet në shërbime cilësore arsimore, në përputhje me parimet dhe misionin e OSBE-së për promovimin e të drejtave të njeriut, integritetin social dhe bashkëjetesën ndërkomunitare.



NEVOJË APO ZGJEDHJE? GATI GJYSMA E LINDJEVE NË KOSOVË BËHEN ME OPERACION



PRISHTINË, 6 SHKURT - Me foshnjën pranë vetes, Arlinda paloste rrobat e vogla të saj në valixhe - gati për të shkuar në shtëpi.

Në Klinikën e Gjinekologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë ajo solli në jetë fëmijën e parë - me peshë gati tre kilogramë. Ishte një moment që e kishte pritur dhe imagjinuar gjatë gjithë shtatzënisë. “Normalisht, jam e lumtur”, thotë ajo, “por më duhet edhe pak kohë që ta marr veten, sepse kam lindur me operacion”.

Vendimi për prerje cezariene erdhi në fund të procesit nga mjekët e saj.

Në aspektin emocional ajo nuk ishte e përgatitur. “...por mjekët e vlerësuan si të nevojshme dhe unë u binda”, thotë Arlinda, identiteti i vërtetë i së cilës është i njohur për redaksinë e Radios Evropa e Lirë.

Në shtratin pranë saj, mëngjesin e 26 janarit, ndodhej edhe Pranvera, një nënë tjetër, me një histori të ngjashme, por një përvojë ndryshe. Ajo kishte lindur fëmijën e parë në mënyrë natyrale, ndërsa këtë herë procesi i mori rrjedhë tjetër. “Dhimbjat më nisën në shtëpi, në Lipjan. Kur erdha në spital, më dërguan në sallën e lindjes. Qëndrova gati dy orë dhe nuk munda të lind normalisht. Më thanë se duhet operacion”, rrëfen Pranvera, duke shtuar se, përveç humbjes së ujit të bebes, arsye tjetër nuk i është shpjeguar.

Dy gra, dy lindje, dy histori personale, por të dyja

pasqyrojnë të njëjtin realitet shëndetësor në Kosovë: rritjen e ndjeshme të lindjeve me prerje cezariene.

Kulmi i tyre u arrit në vitin 2024, kur gati gjysma e lindjeve në vend u realizuan me operacion. Por, sipas të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, ky trend nuk është i njëjtë në të gjitha institucionet: në vitin 2024, spitalet private dominuan për nga numri i lindjeve me prerje cezariene.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) e përkufizon prerjen cezariene si një ndërhyrje kirurgjikale, që përdoret për ta shpëtuar jetën e nënave dhe foshnjave kur komplikimet e bëjnë lindjen natyrale të rrezikshme.

Ndërsa është e dobishme kur ekzistojnë arsye të qarta mjekësore, OBSh-ja paralajmëron kundër përdorimit pa nevojë të prerjes cezariene, duke theksuar se ajo “duhet të kryhet vetëm kur është realisht e domosdoshme për t'i shmangur rreziqet për nënën ose foshnjën”. Sipas studimeve, aplikimi i panevojshëm ose i tepruar i prerjes cezariene mund ta rrisë rrezikun e komplikimeve post-operative, infeksioneve dhe problemeve të mëvonshme obstetrike për gratë.

Frika nga përgjegjësia

Në Klinikën Obstetrike Gjinekologjike të QKUK-së gjatë vitit 2025 u realizuan mbi 7 mijë

lindje, prej të cilave 3 074 me prerje cezariene.

Drejtori i klinikës, Zef Ndrejaj, thotë se mjekët shpesh përballen me dilema të vështira. “Ka raste kur mjekët druajnë se, nëse këmbëngulin në lindje natyrale dhe ajo komplikohet në momentin e fundit, mund të përballen me pasoja serioze”, thotë Ndrejaj për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, operacioni nuk duhet të jetë opsioni i parë, por shpesh bëhet i tillë për shkak të mungesës së protokolleve të qarta.

Ai shton se klinika trajton edhe raste të rënda dhe urgjente të referuara nga e gjithë Kosova - çka ndikon, po ashtu, në statistika.

“Po respektohet dëshira e pacientes”

Shoqata e Obstetërve dhe Gjinekologëve të Kosovës konfirmon rritjen e lindjeve me prerje cezariene.

Kryetari i saj, Naser Rafuna, thotë se një faktor i rëndësishëm në këtë trend është kërkesa e vetë grave. “Gjeneratat e reja janë shumë të interesuara për lindje me operacion. Po respektohet dëshira e pacientes, të them të drejtën”, shprehet ai, duke shtuar se presioni nga familjarët dhe frika nga komplikimet e lindjes normale, i shtojnë gjinekologët të tërhiqen.

Por gjinekologu Arbër Lila, i cili punon në spitalin e Gjakovës, thekson se përgjegjësia për rritjen e lindjeve me prerje

cezariene nuk bie vetëm mbi nënat. “Edhe ne si profesionistë e kemi atë pjesën e ‘kontributit tonë’ në rritjen kaq të madhe të lindjeve cezariene”, thotë ai. Sipas Lilës, mungesa e komunikimit dhe e shpjegimit të procesit të lindjes, si dhe frika nga paditë, ndikojnë drejtpërdrejt në vendimmarrjen e mjekëve. “Lindja normale kërkon kohë, vigjilencë dhe përgjegjësi të madhe, ndërsa prerja cezariene kryhet më shpejt dhe shpesh krijon një ndjenjë ‘lehtësimi’ për të gjithë”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Lila shton se kjo dukuri nuk është specifike vetëm për Kosovën. “Është trend në të gjitha vendet. Shifrat janë pothuajse alarmante - gjendja po i afrohet një barazimi mes lindjeve normale dhe atyre me prerje cezariene”, deklaroi ai.

Një udhërrëfyes ekziston, por zbatimi mungon

Në korrik të vitit 2025, Ministria e Shëndetësisë e Kosovës miratoi udhërrëfyesin klinik për menaxhimin e lindjeve me prerje cezariene, me synimin që gratë të marrin vendime të informuara dhe të bazuara në fakte shkencore.

Dokumenti thekson se gratë duhet të informohen për pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të kësaj procedure dhe se kjo e drejtë u garantohet me ligj. Por, edhe pse ka hyrë në fuqi, udhërrëfyesi vazhdon të mos zbatohet, për faktin se nuk

është integruar plotësisht në punën e përditshme të institucioneve shëndetësore.

Arsyet lidhen edhe me mungesën e mekanizmave mbikëqyrës.

Bordi i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, i cili mbikëqyr QKUK-në dhe spitalet rajonale, ka kërkuar disa herë që numri i lindjeve me prerje cezariene të reduktohet në minimum, si dhe që në secilën dhomë të vendosen njoftime informuese për pacientet lidhur me këtë procedurë. “Aty ku kemi kushte për lindje normale nuk duhet të ketë mundësi për lindje të tjera”, përfundon drejtori i Klinikës së Gjinekologjisë, Zef Ndrejaj.

Trendi në botë

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, prerja cezariene është ndër ndërhyrjet kirurgjikale abdominale më të shpeshta në botë, me një rritje të vazhdueshme globale - nga 6 % e lindjeve në vitin 1990 në 21 % në vitin 2018, ndërsa deri në vitin 2030 pritet të arrijë në rreth 30 %. Parashikimet tregojnë se 38 milionë gra do të lindin me prerje cezariene në vitin 2030, dhe 88 % e këtyre operacioneve do të ndodhin në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

Inspektorati i Tregut mbyll 26 motele dhe villa

PRISHTINË, 6 SHKURT - Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut, që vepron në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka realizuar një aksion të gjerë inspektues në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Inspektoratin Qendror të Punës. Qëllimi i aksionit ishte sigurimi i respektimit të standardeve

ligjore, mbrojtja e konsumatorëve, garantimi i konkurrencës së ndershme dhe verifikimi i përmbushjes së obligimeve ligjore nga subjektet ekonomike. Gjatë këtij operacioni janë inspektuar 69 subjekte ekonomike, me fokus të veçantë në bizneset që ushtrojnë veprimtari në fushën e hotelërisë dhe turizmit, përfshirë vilat dhe motelet në

territorin e Republikës së Kosovës. Në bazë të kompetencave ligjore, inspektorët e Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut kanë urdhëruar mbylljen e përkohshme të 26 subjekteve ekonomike, kryesisht për mosregjistrim të bizneseve dhe mungesë të pëlqimeve apo aktvendimeve që dëshmojnë plotësimin e kushteve minimale

teknike. Ndaj operatorëve ekonomikë që ushtronin aktivitetin e tyre në kundërshtim me legjislacionin në fuqi janë shqiptuar gjithsej 27 masa ndëshkuese. Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut ka bërë me dije se veprimtari të ngjashme inspektuese do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, me qëllim forcimin e sundimit të ligjit dhe krijimin e një mjedisi



të sigurt, të rregullt dhe transparent për zhvillimin e veprimtarive ekonomike në Republikën e Kosovës.

GUVERNATORI I BQK-së: SEKTORI BANKAR I KOSOVËS MBETET NDËR MË TË QËNDRUESHMIT NË RAJON

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 SHKURT - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë në panelin me temë “Sektori bankar dhe financiar i Kosovës: Një mundësi reale për investitorët francezë”, i organizuar në kuadër të konferencës “Dita e Biznesit Francez”.

Konferenca u organizua nga Ambasada e Francës në Kosovë dhe Këshilli i Investitorëve Evropianë, duke mbledhur përfaqësues të lartë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, si dhe duke përfshirë katër panele tematike me fokus aktual.

Gjatë diskutimit në panel, guvernatori Ismaili paraqiti zhvillimet kryesore në ekonominë e vendit, reformat e ndërmarra nga BQK-ja si dhe stabilitetin financiar. Ai theksoi se sektori bankar i Kosovës mbetet ndër më të qëndrueshmit në rajon, i mbështetur nga nivele të larta të kapitalizimit dhe likuiditetit, si dhe nga një nivel i ulët i kredive joperformuese, duke luajtur rol kyç në mbështetjen e aktivitetit ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

Më tej, guvernatori Ismaili shpalosi angazhimin e BQK-së për forcimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse, promovimin e produkteve dhe



shërbimeve financiare inovative, si dhe avancimin e gjithëpërfshirjes financiare, me qëllim të krijimit të një sektori financiar të qëndrueshëm, konkurrues dhe të integruar me tregjet ndërkombëtare. Stabiliteti financiar përforcohet nga korniza ligjore dhe rregullative e harmonizuar me atë të Bashkimit Evropian, si dhe nga përdorimi i euros si valutë zyrtare, të cilat garantojnë siguri juridike dhe kushte të barabarta konkurrence për bizneset dhe

investitorët nga vendet e BE-së. Në këtë kontekst, guvernatori i BQK-së vuri në pah rëndësinë e inovacionit financiar dhe digjitalizimit si parakushte thelbësore për krijimin e një mjedisi tërheqës për investime të huaja. Më tutje, guvernatori Ismaili elaboroi mbi nevojën për diversifikimin e burimeve të financimit përtej sektorit bankar, përfshirë avancimin e skemave garantuese dhe zhvillimin e tregut të kapitalit, me qëllim të zgjerimit të

mundësive për tregti dhe investime si dhe rritjes së konkurrencës në ekonomi. Ai foli edhe për agjendën e digjitalizimit dhe integritetive në sektorin financiar, duke përfshirë modernizimin e infrastrukturës së pagesave përmes projektit të pagesave të shpejta TIPS Clone, progresin drejt anëtarësimit në SEPA, bankingun e hapur si dhe iniciativat rajonale që synojnë rritjen e efikasitetit dhe ndërveprueshmërisë së sistemeve financiare. Plani i

Rritjes së Bashkimit Evropian dhe projektet e tjera me institucionet financiare ndërkombëtare, të cilat pritet të ratifikohen nga Kuvendi, janë gjithashtu në funksion të arritjes së këtyre objektivave.

Krahas nxitjes së inovacionit, BQK-ja po forcon mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve financiare, standardet e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e konsumatorit, duke siguruar që modernizimi i sistemit financiar të shoqërohet me ruajtjen e plotë të stabilitetit financiar.

Në përfundim, guvernatori Ismaili nënvizoi se sektori financiar i Kosovës kombinon stabilitetin, modernizimin dhe inovacionin brenda një kornize konkurruese të harmonizuar me Bashkimin Evropian. Me një sistem bankar stabil dhe konkurrues, infrastrukturë moderne, potencial në rritje në fushën e fintech-ut dhe një mjedis tatimor tërheqës, Kosova ka potencial të shndërrohet në një destinacion strategjik investimi, me perspektiva të qarta për rritje afatgjatë dhe integrim evropian.

BQK-ja mori pjesë në këtë konferencë në kuadër të rolit të saj proaktiv për nxitjen e dialogut profesional dhe promovimin e bashkëpunimit, në funksion të ndërtimit të sistemeve financiare më të qëndrueshme, më të sigurta dhe më të integruara në rajon, në përputhje me Planin Strategjik të BQK-së.

AUV bllokoi produktin ushqimor për foshnja “Beba suprem pre” 800 gramë

PRISHTINË, 6 SHKURT - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ka njoftuar se, bazuar në njoftimin zyrtar të pranuar nga Republika e Shqipërisë, përkatësisht nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, është konstatuar se subjekti “Rossmann & Lala SH.P.K.” në Shqipëri ka eksportuar në Republikën e Kosovës produkt ushqimor për foshnja “Beba suprem pre”, 800 gramë, me

datë skadimi 05.2027 dhe kod identifikues EAN: 7613287226631, importuar nga kompania “Rossmann Kosova”. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë njofton se, në bashkëpunim me kompaninë përkatëse, është bërë bllokimi i këtij produkti dhe se së shpejti do të fillojë procesi i asgjësimit në përputhje me legjislacionin në

fuqi. Pavarësisht prej sfidave me të cilat po përballlet, përfshirë mungesën e inspektorëve, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë mbetet e përkushtuar për monitorimin e vazhdueshëm të tregut dhe të zinxhirit ushqimor, me qëllim të garantimit që konsumatorët në Republikën e Kosovës të kenë në dispozicion ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm.



AKTORËT E FAMSHËM TË VJETËR KINEMASË PO JOSHEN DREJT EKRANIT TELEVIZIV PRANË JUSH



Nga: Fiona STURGES /
The Guardian (titulli: *It's the
Hollywood sensation we're all
enjoying: ageing cinema
megastars lured to a TV screen
near you*)

Shrinking, seriali televiziv për Xhimin që luhet nga Jason Segeli, një psikoterapist në zi që nuk pushon duke ua thënë pacientëve atë që ai me të vërtetë mendon, duket mjaft i padëmshëm në letër. Nga Frasier te In Treatment e deri te Sex Education, nuk ka mungesë dramash televizive për terapeutë të çrregullt. Ajo që e veçon Shrinking nga të tjerat është prania e Harrison Fordit, i cili luan mentorin tetëdhjetëvjeçar të Xhimit. Këtu shohim një superyll të Holivudit që drogohet me ushqime që përmbajnë ekstrakte kanabisi, përballat me dështimet e tij si baba dhe përpiqet të fshehë simptomat e Parkinsonit. Edhe pse Segeli ka rolin kryesor bashkë me Fordin, ky i fundit është atraksioni kryesor dhe ka të gjitha frazat më të mira.

1923 e Paramount-it, pararendësja e Yellowstone-i nga Taylor Sheridan, gjithashtu shfrytëzon statusin e Fordit si figurë e rëndësishme, duke treguar përpjekjet e një familjeje blegtorësh për të ruajtur pasurinë dhe statusin gjatë Depresionit të

Madh. Partnerja e Fordit është Helen Mirren, një tjetër aktore tetëdhjetëvjeçare që ka luajtur më parë me të në filmin e vitit 1986, The Mosquito Coast. Me ngjarjet që zhvillohen në Montana, 1923 është një dramë me stil që e kthen në art pamjen e ashpër të protagonistëve, së bashku me prijet e tyre për brutalitet.

Pra, çfarë të themi për të moshuarit e kinemasë që po ushtrojnë zanatin në ekranin e vogël? Në të kaluarën, yjet e Holivudit të Vjetër do të ishin tmerruar nga kalimi në TV. Po ta bëje një gjë të tillë, kjo do të ishte shenjë e qartë se karriera jote është në rënje - ndonëse Barbara Stanwyck dhe Joan Collins e injoruan këtë qëndrim snob në vitet '80 të shekullit XX, kur iu bashkuan kastit të The Thorn Birds dhe Dynasty. Collinsi u bë yll edhe më i madh si super-negativja Aleksis Kerington në Dynasty, më shumë sesa kishte qenë si një vajzë e re nën kontratë me produksionin 20th Century Fox duke luajtur në filmat si Land of the Pharaohs dhe The Opposite Sex. Në anën tjetër, paraqitja e turpshme e Charlton Hestonit në serialin pasues të Dynasty-së, The Colbys, pati efektin e kundërt, duke ia vrarë përfundimisht karrierën. Pas kësaj, aktori u përqendrua si mysafir në shfaqjet komike dhe në tubimet e mbështetësve për mbajtje të

armëve [NRA].

Peizazhi televiziv i sotëm duket qartësisht ndryshe për yjet e Holivudit që dëshirojnë të zgjerojnë karrierën, duke ofruar më shumë larmi dhe, në përgjithësi, një klasë më të lartë drame sesa dikur. Mendoni për Meryl Streepin, e cila u shfaq në sezonin e dytë të Big Little Lies më 2019 dhe më pas u bashkua me qejf në komedinë e suksesshme të Hulu-s, Only Murders in the Building. Ose Gary Oldmanin - i cili ka interpretuar Drakulën dhe Çërcillin në ekranin e madh - si një agent i moshuar që ka nevojë për dush në serialin televiziv Slow Horses. Ose Kathy Bates që luan avokaten shtatëdhjetëvjeçare në Matlock, ku nënvlerësohet vazhdimisht për shkak të moshës. Ose Sly Stallone që bën debutimin e tij në TV si mafioz veteran në Tulsa King, një tjetër serial nga Taylor Sheridan. Në fakt, Sheridan, i cili së fundmi ka angazhuar Kevin Costnerin dhe Billy Bob Thorntonin në Yellowstone dhe Landman, duket se është në një mision për të nxjerrë nga pensioni aktorët veteranë.


Pak prej këtyre yjeve të plakur mund të akuzohen se po bien poshtë nivelit në ato që janë kryesisht prodhime me buxhet të lartë, edhe pse e kanë të vështirë të bien në sy në këtë epokë ku ka tepër shumë seriale televizive.

Gjithashtu, nuk ka ndonjë ndjesi se po ushqehen me lavditë e së kaluarës. Kur Jeff Bridges, ylli i ekranit të madh në The Fisher King dhe The Big Lebowski u bind të rikthehej në TV për të luajtur një ish-agent të CIA-s i cili e ka të vështirë të veshë çorapet në mëngjes, e bëri këtë më lehtë për serialin me titull të qartë të FX Networks-it, The Old Man. Në Shrinking, Fordit i kërkohet të përballat haptazi me statusin e tij si i moshuar dhe të portretizojë luftën e personazhit të tij me sëmundjen që po përparon. Krahasoni këtë me ribërjen e Indiana Xhonsit në vitin 2023, Dial of Destiny, ku, në moshën 80-vjeçare, ai e ripërsërit rolin e heroit aksion me kamxhik dhe plot skena me stërvitje fizike. Fakti që po shkruhen role të plota për televizion vetëm për të moshuar, ky është një lajm i mirë - padyshim një përmirësim në krahasim me nxjerrjen në pension në moshë të mesme, siç bënte zakonisht Holivudi deri vonë - por, aktualisht janë ende burrat ata që kanë pjesën më të madhe të këtyre roleve. Në aktrim, si dhe në jetë, moshë ka qenë gjithmonë më e pamëshirshme për gratë, një situatë që është satirizuar në mënyrë mjeshtrorë në skeçin e Amy Schumerit, Last Fuckable Day, ku tri aktore - Julia Louis-Dreyfus, Tina Fey dhe Patricia

Arquette - shënojnë ditën e fundit kur njëra prej tyre konsiderohet "seksualisht tërheqëse" në sytë e industrisë së argëtimit.

Një faktor tjetër që po i shtyn aktorët veteranë të kërkojnë punë në televizion është se industria e filmit ende po ndien goditjen financiare nga koronavirusi dhe nga grevat e skenaristëve dhe aktorëve në vitin 2023. Buxhetet mbeten të ngushta dhe sukseset e mëdha janë gjithnjë e më të rralla - vitin e kaluar, Snow White, Mickey 17, Christy, After the Hunt dhe filmi i Dwayne Johnsonit, The Smashing Machine, dështuan tërësisht në të hyra. Ndërkohë, shikuesit kanë mundësinë të presin që filmat e mëdhenj të shfaqen në platformat në internet - ndonjëherë vetëm disa ditë pas premierës në kinema.

Nuk është çudi, pra, që aktorët më të moshuar duan të përfshihen në TV, ku mund të shihen nga ata shikues që nuk duan të shkojnë në kinema, dhe ku mund të kalojnë kohë duke zhvilluar personazhe më kompleksë. Ndërkohë, serialet po përfitojnë në peshë, përvojë dhe cilësi yjesh. Aktualisht ka shumë arsye për të qenë pesimist për industrinë krijuese, por kjo është një epokë e artë për aktorin në prag pensioni për të cilin po afrohen lavdi të reja dhe një akt i tretë në karrierë. /Telegrafi/



Nations League 2026/27: Kosova dhe Shqipëria presin shortin e ri

PRISHTINË, 6 SHKURT - Sezoni i ri i Nations League është gati të nisë, këtë herë i lidhur me kualifikueset për Euro 2028, ku skuadrat që përfundojnë në vendet e

larta sigurojnë të paktën një vend në play-off. Në garë janë edhe Kosova dhe Shqipëria, me "dardanët" në Ligën B dhe "kuqezinjtë" në Ligën C.

Një javë para shortit janë përcaktuar edhe vazot e ekipeve: Kosova do të jetë në vazot e katërt të Ligës B, ndërsa Shqipëria në vazot e parë të Ligës C. Shorti i

Nations League 2026/27 do të hidhet më 12 shkurt, dhe të dy kombëtares presin me padurim për t'i mësuar kundërshtarët e tyre në këtë edicion.



KOSOVA SYNON MEDALJE NË PARIS GRAND SLAM 2026 TË XHUDOS

PARIS, 6 SHKURT - Spektakli ndërkombëtar i xhudos, Paris Grand Slam 2026, do të zhvillohet sot (e shtunë) dhe nesër (e diel) në kryeqytetin francez, duke mbledhur 499 garues nga 80 shtete të 6 kontinenteve. Ky event konsiderohet një nga më prestigjiozët në kalendarin botëror të xhudos dhe ofron pikë të rëndësishme për renditjen dhe kualifikimet olimpike. Vëmendja kryesore pritet të jetë te Distria Krasniqi dhe Laura Fazliu, ndërsa gjenerata e re do të kërkojë të lërë gjurmë në një garë të nivelit Grand Slam. Ekipi i Kosovës do të udhëhiqet nga Driton Kuka, arkitekti i sukseseve historike të xhudos së Kosovës, bashkë me trajneren Majlinda Kelmendi, duke kombinuar përvojën dhe mentalitetin fitues të ekipit. Ky



XHUDISTËT ELITARË ME TË CILËT PËRFAQËSOHET KOSOVA:


Erza Muminoviq (-48 kg)
Distria Krasniqi (-52 kg)
Fatjona Kasapi (-52 kg)
Flaka Loxha (-57 kg)
Laura Fazliu (-63 kg)
Akil Gjakova (-73 kg)

event paraqet një mundësi të shkëlqyer për Kosovën për medalje dhe afirmim ndërkombëtar, duke treguar edhe një herë fuqinë e saj në skenën botërore të xhudos.

SHAQIRI LË PRAPA RIVALËT, LOJTARI ME MË SË SHUMTI KONTRIBUTE NË LIGËN ZVICERANE

BASEL, 6 SHKURT - Edhe në këtë sezon një gjë mbetet e pandryshuar te FC Baseli, roli vendimtar i Xherdan Shaqirit. Edhe pse nuk po arrin plotësisht nivelin e jashtëzakonshëm të sezonit të kaluar kampion, mesfushori ofensiv vazhdon të jetë "jeta" e skuadrës së Baselit. Shaqiri është i përfshirë drejtpërdrejt në më shumë se gjysmën e golave të shënuara nga "Bebbi" këtë sezon, një statistikë që flet qartë për varësinë e kampioneve në fuqi nga ish-lojtari i kombëtares zvicerane. Kontributi i tij, qoftë me gola apo asistime, mbetet vendimtar në ecurinë e skuadrës. Për Baselin është fat i madh që ka në radhët e veta një futbollist të tillë, me përvojë dhe cilësi të lartë individuale. Megjithatë, kjo statistikë njëkohësisht ngre edhe alarmin: në momentin që Shaqiri mungon, Baseli përballet me probleme serioze në fazën ofensive. Kampionët aktualë kanë treguar se pa liderin e tyre kryesor e kanë të vështirë të gjejnë zgjidhje dhe kreativitet në lojë. Shaqiri është lojtari që ka kontribuuar më së shumti me gola e asistime, nga

të gjithë lojtarët e kampionatit zviceran. Në 21 ndeshje, Shaqa i ka realizuar nëntë gola, por ka bërë edhe 10 asistime, pra një kontribut prej 19 golave në këtë sezon deri më tani, që është më së shumti te skuadra e tij dhe në ligë. 34 gola i ka shënuar Baseli në këtë edicion dhe 19 prej tyre mbajnë vulën e Shaqirit, me një përqindje të pjesëmarrjes prej 55.9-përqindësh, që është më e larta në ligë. Dy javë më parë ai realizoi hetrik dhe asistoi njëherë për ta vendosur i vetëm derbin ndaj Zurichut.



RIKTHEHEN SUPERLIGA DHE LIGA E PARË E FUTBOLLIT



PRISHTINË, 6 SHKURT - Stinori pranveror i Superligës së Kosovës në futboll zyrtarisht nis sot (e shtunë). Federata e Futbollit e Kosovës tashmë ka publikuar orarin e pesë ndeshjeve që do të luhen në kuadër të xhiros së 19. Prej pesë

ndeshjeve, tri do të luhen sot (e shtunë) dhe dy të tjera nesër (e diel), kurse të gjitha startojnë në orën 13:00. Dukagjini - Prishtina, Drenica - Llapi dhe Ferizaj - Drita, janë përballjet e ditës së sotme. Ndërkohë, xhiro do të mbyllet nesër me ndeshjet

Gjilani - Ballkani dhe Malisheva - Prishtina e Re. Krahas Superligës do të nisë edhe stinori pranveror në Ligën e Parë të Kosovës, me katër ndeshje që do të luhen sot dhe pesë nesër. Të gjitha këto ndeshje luhen në orën 13:00.

Ramiz Sadiku - Istogu, Rilindja - Tefik Çanga, Trepça - Prizreni, Suhareka - KEK-u, Liria - Trepça '89, Kika - Vushtrria, Besa - Feronikeli '74, Vëllaznimi - 2 Korriku dhe Dinamo - Vjosa, janë duelet e xhiros së 19.

Trajneri Kakiouzis largohet nga Prishtina

PRISHTINË, 6 SHKURT - Trajneri nga Greqia, Michalis Kakiouzis, më nuk është trajner i Sigal Prishtinës. Klubi i Superligës së Kosovës në basketboll ka njoftuar për largimin e grekut Kakiouzis. Ai kishte marrë

drejtimin e Prishtinës para fillimit të sezonit, por është larguar për arsye familjare. "Klubi ynë shpreh falënderimet më të sinqerta për trajnerin Michail Kakiouzis për kontributin, profesionalizmin


dhe përkushtimin e treguar gjatë këtij sezoni, si dhe për bashkëpunimin korrekt dhe angazhimin e vazhdueshëm në punën me ekipin", ka njoftuar Sigal Prishtina. Klubi ka falënderuar trajnerin

dhe i ka dëshiruar suksese në vazhdim të karrierës. "Për arsye familjare, nga dita e sotme trajneri Michail Kakiouzis nuk do të jetë më pjesë e klubit tonë", ka njoftuar Sigal Prishtina.



Ziraat Bank	ZIRAAT BANK KOSOVA SH.A	
Bilanci i gjendjes me : 31.12.2025	Euro'000	Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Pasurite		
Paraja e gatshme dhe gjendja me BQK-në	19,999	30,823
Kërkesat ndaj bankave	783	1,240
Plasmanet ne Institucionet kreditore	-	4,000
Kreditë dhe paradhëniat ndaj klientëve	103,194	100,315
Investimet në letra me vlerë	6,670	6,321
Patundshmëritë dhe pajisjet	1,839	1,743
Pasuritë e paprekshme	333	350
Pasuritë tatimore të shtyra	123	123
Pasuritë tjera	689	729
Gjithsej pasuritë	133,629	145,642
Detyrimet		
Detyrimet ndaj bankave	9,007	14,057
Depozitat e klientëve	98,608	106,654
Fondet tjera të huazuara	-	-
Detyrimet tatimore të shtyra	-	-
Detyrimet tjera	1,024	1,030
Gjithsej detyrimet	108,640	121,742
Ekuiteti i aksionarëve		
Kapitali aksionar	25,000	25,000
Rezervat e kapitalit	-	-
Fitimi i mbajtur	951	951
Fitimi/(humbja) i vitit aktual	-	962
Përbërësit tjerë të ekuitetit	-	-
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve	24,989	23,900
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet	133,629	145,642

Ziraat Bank	ZIRAAT BANK KOSOVA SH.A	
Pasqyra e të ardhurave me: 31.12.2025	Euro'000	Euro'000
	Tremujori paraprak	Tremujori vijues
Të hyrat nga interesi	6,164	8,007
Shpenzimet e interesit	-	-
Neto të hyrat nga interesi	3,521	4,518
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	329	451
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	-	-
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet	19	139
Neto të hyrat tjera	65	159
Neto të hyrat (shpenzimet) tjera operative	-	-
Gjithsej të hyrat	962	773
Provizionet për humbjet nga kreditë	-	-
Provizionet tjera	76	437
Fitimi/(humbja) para tatimit	962	2,051
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
Shpenzimet e tatimit të shtyer	-	-
Fitimi/(humbja) neto	962	2,051
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	962	2,051



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT



Tel: +377 45 400 156

 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jeton Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Profesionale Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Filloreta Alija shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Ahmet Rustemi” Bec Gjakovë, nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Arlind Nimani shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Xhelal Lyta shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Florent Zeqa shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10. 11. 12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Andi Reznici shpall të pavlefshme diplomën e shkolës se mesme ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.

- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjimnazit “Gjon Buzuku” Prizren.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollëshishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

